VENDIM
Nr.10, datë 16.5.1997

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i ""
Veli Budo,	Anëtar i ""
Franc Jakova,	Anëtar i ""
Halil Kopani,	Anëtar i ""
Kristofor Peçi,	Anëtar i ""
Zija Vuci,	Anëtar i ""
Alfred Karamuco,	Anëtar i ""

me sekretare Drita Fi1to, me datë 24.4.1997 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr .15 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: GRUPI I KËSHILLTARËVE SOCIALISTË, pranë Këshillit të Rrethit Tepe1enë, të përfaqësuar nga Z.Dashamir Kamberi, Feti Dema e Beg Musta.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SEKRETARIATI I PUSHTETIT LOKAL, në mungesë.
2. KRYETARI I KËSHILLIT TË RRETHIT, i përfaqësuar nga sekretari i këtij këshilli, Z.Rifat Alite.

OBJEKTI:

Shpa1lja e pav1efshme e zgjedhjes së nënkryetarit të Këshillit të Rrethit Tepelenë si dhe e kryesisë së ketij këshilli.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi kërkuesit, subjektin e shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Pas zgjedhjeve të 20 tetorit 1996 për organet e pushtetit lokal, në datën 13.11.1996 është organizuar mbledhja e parë e këshilltarëve të rrethit të Tepelenës për zgjedhjen e kryetarit, zëvëndëskryetarit dhe anëtarëve të kryesisë.

Votimi ka filluar për kryetarin dhe, me balotazh është zgjedhur zoti Sotir Ceka.

Për postin e zëvëndëskryetarit ka pasur tre kandidatë të cilët në votim kanë fituar Ylli Kerçani i PS-së - 11 vota, Bashkim Rapi i PSD-së - 10 vota dhe Gëzim Memlika i PD-së - 2 vota.

Grupi socialist i këshilltarëve ka pretenduar se ka fituar kandidati i tyre, duke interpretuar në rastin konkret nenin 50 të Ligjit nr.7572, datë 10.06.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal", sikur fitonte ai kandidat që kishte më shumë vota se të tjerët. Meqënëse ky pretendim nuk u pranua nga grupet e tjera të këshilltarëve, mbledhja u ndërpre.

Në datën 30.12.1997, u bë përsëri mbledhja duke qenë vetëm 15 anëtarë të këshillit. Me insistimin e grupit të këshilltarëve të Partisë Demokratike, u kalua përsëri në votimin për nënkryetar të këshillit të rrethit ku tre këshilltarët socialistë abstenuan. Sipas procesverbalit këtë votim e fitoi Z.Bashkim Rapi me 12 vota. Më pas u kalua në zgjedhjen e kryesisë ku morën pjesë edhe tre këshilltarët socialistë.

Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjes si dhe nga shpjegimet e dhëna, Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin që në zgjedhjen e zëvëndëskryetarit të këshillit të rrethit të Tepelenës e të anëtarëve të kryesisë janë lejuar shkelje të ligjit, që i bëjnë të cënueshme këto akte.

Së pari: Neni 50 i ligjit të sipërcituar është shprehur qartë se për zgjedhjen e kryetarit,

nënkryetarit e të kryesisë së këshillit të rrethit, nevojitet shumica e votave të këshilltarëve të pranishëm. Në rastin konkret meqë në mbledhjen e datës 13.11.1996 morën pjesë 23 anëtarë, është e kuptueshme se shumica nuk përbëhet as nga 10 apo 11 vota, ashtu siç kanë pretenduar kërkuesit. Nëse shumica nuk arrihet në votimin e parë, në bazë të praktikës së gjithëpranuar për zgjedhjet organizohet balotazhi. Këtë qëndrim ligjor mban edhe Kujtesa nr.3, datë 30.10.1996 e Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal, që ka karakterin e udhëzimit.

Në këto kushte, meqënëse mbledhja për zgjedhjen e zëvëndëskryetarit nuk ka përfunduar, mosorganizimi i balotazhit dhe braktisja e zgjedhjeve nga një pjesë e këshilltarëve përbën shkelje të ligjit.

Së dyti: Edhe organizimi i mbledhjes së datës 30.12.1996, si vazhdim i mbledhjes për kushtetuimin e këshillit të rrethit është bërë me shkelje të rëndësishme të ligjit. Në bazë të nenit 9 të Ligjit "Për organizimin e pushtetit lokal" mbledhja nuk mund të bëhej, pa marrë pjesë në të të paktën 2/3 e anëtarëve. Në fakt në mbledhje kanë marrë pjesë 15 anëtarë, pra më pak se 2/3 gjë që e bën këtë mbledhje të pavlefshme.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Repub1ikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24 pika 3 e 5, 25 dhe 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e p1otësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", njëzëri,

VENDOSI:

1. Të deklarojë të pavlefshme zgjedhjen e zëvendëskryetarit të këshillit të rrethit Z.Bashkim Rapi, si dhe zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë.

2. Të urdhërojë zhvillimin e ba1otazhit midis dy kandidatëve për zëvendeskryetar këshilli që kanë marrë më shumë vota.

3. Të urdhërojë zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarët e kryesisë në përputhje me dispozitat ligjore .

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Tiranë, më datë 16.5.1997